

**S T A T U T I**  
**I SHOQËRISËME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**I&M PLATINUM TRADING LIMITED**

Në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në bazë të vendimit të asamblesë së ortakëve datë 21 Shkurt 2020 dhe të prokurës së përgjithshme datë 27.02.2020 të shoqërisë tregtare të së drejtës serbe **I&M TRADING LIMITED D.O.O.** e themeluar dhe e regjistruar rregullisht në shtetin e Serbisë me qender ne Beograd Zvezdara, 4 (kater) Rruga Stjepana Ljubiše, numri i shoqerisë: 21494780, Nr i identifikimit tatimor 1 11518072, me ortak dhe administratorë të vetëm znj. Ida Miloš, lindur ne Zagreb, Republika e Kroacisë, më datë 22.08.1963, dhe me banim ne 116 (njeqind e gjashtëmbedhjete) A, Družilovec e identifikuar me anë të pasaportës me nr. 026556320, lëshuar më datë 18.04.2012 nga Policia e Zagreb, dhe e vlefshme deri më 1 datë 8.04.2022 me vullnetin e tyre të lirë dhe të plote, të shprehur në nënshkrimin e aktit të themelimit:

- Z. Fabjan Mehmeti**, shtetas shqiptar, lindur me 25.03.1978 ne Corovod Skrapar dhe i identifikuar nëpërmjet kartës se identitetit shqiptare me nr. Personal H80325186Q e vlefshme deri më datë 23.11.2029;
- Z. Gentjan Zoto**, shtetas shqiptar, lindur me 26.05. 1978 ne Vlore dhe i identifikuar nëpërmjet kartës së identitetit shqiptare me nr. Personal H80S26085D e vlefshme deri më datë 28.01.2030;

**Nënshkruan statutin si me poshtë vijon:**

**NENI 1**

**EMËRTIMI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI:**

Emri i shoqërisë është **I&M PLATINUM TRADING LIMITED sh.p.k.**, më poshtë e referuar si shoqëria

**NENI 2**

**SELIA E SHOQËRISË:**

Selia e shoqërisë ndodhet në **Rruga e Durrësit n. 210/2 Njësia Bashkiaken.10 Tiranë-Shqipëri**.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA E SHOQËRISË:**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Shoqëria do të marrë personalitet juridik në momentin e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) Tiranë.

**NENI 4**

**OBJEKTI I SHOQËRISË:**

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë por nuk do të kufizohet vetëm në shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave, procesime te transaksioneve online, POS online, transferimi elektronik i fondeve, E-komerce, menaxhimi elektronik i inventarëve, sisteme automatike të mbledhjes të dhënavë, marketing dixhital, platforma (blockChain), kriptovaluta, shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime te tjera ndihmese.

Agjentit për transferta parash në emër dhe për llogari të subjekteve financiare jobankare. Veprimtari e agjentit për shërbimin e pagesave për të tretët në emër dhe për llogari të subjekteve financiare jobankare.

Konsulenc për zhvillimin e sistemeve informatike, të menaxhimit të databasave (të dhënat informatike), informimin e sistemit të sigurisë informatike dhe mbi teknologjinë informatike në sektorin financier.



Zgjidhje telekomunikacioni (telecommunication solutions). Shërbime në faqe internet (website services). Zgjidhje hardware dhe software (hardware and software solutions). Riparim dhe shitjesh kompjuterash dhe pajisjesh te ndryshme informatike, sofware të ndryshëm.

Menaxhim projektesh ne sistemin informatik. Import, eksport, ndermjetesime, agjent komisioner, tregti artikuj te ndryshëm, makineri, pajisje dhe produkte për nevojat e veta dhe për të tretë.

Për realizimin e objektit te mësipërm, Shoqëria mund edhe të kryej çfarëdo lloj aktiviteti tjeter që mund të konsiderohet i dobishmen ose i nevojshëm për realizimin e qëllimeve të saj duke përfshirë çdo aktivitet i cili nuk është i ndaluar nga legjislacioni ne fuqi.

#### **NENI 5**

#### **KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË:**

Kapitali themeltare i shoqërisë do te jete 100.000 (njëqindmijë) Lekë dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë që i përket ortakut si me poshtë:

**Ortaku themelues: I&M TRADING LIMITED D.O.O.** e themeluar dhe e regjistruar rregullisht në shtetin e Serbisë me qender ne Beograd Zvezdara, 4 (kater) Rruga Stjepana Ljubiše, numri i shoqerisë: 21494780, Nr i identifikimit tatimor 1 11518072, me ortak dhe administratorë të vetëm znj. Ida Miloš, lindur ne Zagreb, Republika e Kroacisë, më datë 22.08.1963, dhe me banim ne 116 (njeqind e gjashtëmbëdhjete) A, Družilovec e identifikuar me anë të pasaportës me nr. 026556320, lëshuar më datë 18.04.2012 nga Policia e Zagreb, dhe e vlefshme deri më 1 datë 8.04.2022, që do të zoterojë 1 (një) kuotë me një vlerë totale prej Lekë 100.000 (njëqindmijë), e cila do të përbëjë 100 % (njëqindpërqindë) të kapitalit themeltarë të shoqërisë.

Kapitali themeltar mund të zgjedhë ose mund të rritet dhe është plotësish i likuiduar dhe i nënshkruar.

#### **NENI 6**

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali i saj filletar, nga pasuri të luajtshme ose të pa luajtshme dhe nga të tjera pasuri që janë dhënë dhe do të jepen, të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë.

#### **NENI 7**

Kuotat e kapitalit themeltar do të derdhen nga themeluesi në Bankë, në llogarinë bankare në emër të shoqërisë , dhe derdhjet e kuotave regjistrohen në librin e llogarive te shoqërisë.

#### **NENI 8**

Fitimet e shoqërisë i ta kojnë ortakut te saj. Asambleja e përgjithshme vendos në bazë të ligjit shpërndarjen ose investimin e fitimeve duke vendosur dhe mënyrat.

#### **NENI 9**

Shoqëria, është përdoruese dhe mbajtëse e pasurisë së krijuar. Ajo mund të marrë dhe të ushtroje të drejta të tjera, materiale dhe jo materiale, përfshire dhe të drejtën e shitjes se pasurisë se krijuar të tretëve.

Ne Republikën e Shqipërisë, shoqëria gjëzon të drejta të barabarta me çfarëdolloj personi tjeter juridik, shqiptar ose të huaj, në bazë të legjislacionit në fuqi.

#### **NENI 10**

Shoqëria, vepron në regjimin e pronësisë private dhe merr përsipër të gjitha detyrimet dhe të drejtat brenda kufirit të kapitalit të saj.

Ortaku merr përsipër rezikun e aktivitetit te shoqërisë vetëm brenda limitit te kapitalit themeltar te investuar në të.

#### **NENI 11**



## DREJTIMI DHE MENAXHIMI I SHOQËRISË:

Bëjnë pjesë në detyrimet dhe kompetencat e ortakut, mbledhur ne asamble të përgjithshme, të gjitha ato që janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe të listuar në ketë statut. Ndër këto detyra përfshihen:

- modifikimi i aktit të themelimit dhe statutit;
- miratimi i buxhetit vjetor, të veprimtarisë së administrimit, të inventarit, të bilancit të llogarisë vjetore;
- emërimi dhe shkarkimi i administratorëve ortakë e jo-ortake dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të tyre, duke përcaktuar se për emërimin dhe për shkarkimin nuk do të jetë e domosdoshme të jepet shprehimisht një shkak;
- miratimi i huave dhe i garancive;
- miratimi i tarifave për shërbimet që kryen shoqëria;
- përcaktimi i formës se vulës dhe të markës se shoqërisë;
- zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë;
- mbikëqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;
- miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;
- vendimin lidhur me krijimin apo mbylljen e filialeve, përfaqësive ose te agjencive te shoqërisë;
- vendimin për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- vendimin për nisjen e një mosmarrëveshje ligjore apo për zgjidhjen e një mosmarrëveshje ligjore në të cilën është e përfshirë shoqëria;
- vendimin për emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar apo të konsulentëve të tjerë, qofte persona fizikë, qoftë juridikë;
- vendimin për ndarjen e kuotave dhe për anulimin tyre;
- vendimin për miratimin dhe ndryshimin e rregullave të procedurës për mbledhjen e asamblesë;
- vendimin për dhënen ose revokimin e prokurave/autorizimeve te përfaqësimit të shoqërisë;
- vendimin për shitjet e kuotave të shoqërisë dhe për të shitur ndërmarrjen ose filialt e saj, ne rastin kur e vlerëson të nevojshme;
- vendimin për çështje të tjera të parashikuara me ligj apo nga statuti;
- marrjen e çdo vendimi tjetër qe nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër.

## NENI 12

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi te dërguar nga administratori drejt ortakëve me shkresë ose sipas zgjedhjes së administratorit nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të përbaje vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e duhet t'u dërgohet te gjithëve jo me vone se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas mënyrës se lartpërmendor, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët janë dakord, për te marre këto vendime, pavarësisht nga mungesa e njoftimit për thirrje.

## NENI 13

Vendimet e asamblesë se përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim.

Procesverbal i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të shoqërisë nën kujdesin e administratorit.

Vendimet e asamblesë së përgjithshme mund të merren edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### NENI 14

Administratorët e shoqërisë do të janë:

1. **Z. Fabjan Mehmeti**, shtetas shqiptar, lindur me 25.03.1978 ne Corovod Skrapar dhe i identifikuar nepermjet kartes se identitetit shqiptare me nr. Personal H80325186Q e vlefshme deri më datë 23.11.2029;
2. **Gentjan Zoto**, shtetas shqiptar, lindur me 26.05. 1978 ne Vlore dhe i identifikuar nëpermjet kartës së identitetit shqiptare me nr. Personal H80S26085D e vlefshme deri më datë 28.01.2030.

Tëcilët do të ushtrojnë të gjitha veprimtaritë e administrimit të aktivitetit të shoqërisë konform me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Administratorët emërohen për 5 (pesë) vjet duke filluar nga data e regjistrimit te shoqërisë në QKB, me të drejtën për tu rizgjedhur, nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos që të shkarkoja atë nga kjo detyrë para përfundimit të këtij mandati, ose në rastin e paraqitjes më përpara të dorëheqjes nga ana e administratorit sipas procedurave të parashikuara nga ligji.

#### NENI 15

Administratorët si veç e veç por edhe bashkarisht kanë të gjitha kompetencat e plota në bazë të ligjit pa asnjë përashtim apo kufizim mbi administrimin e shoqërisë. Administratorët do të janë veç e veç përgjegjës, duke u përgjigjur para çdo të treti perfshire organet shtetërore veç e veç për vendimet, veprimet apo mosveprimet e tyre, për përbushjen e funksioneve të tyre, duke ushtruar veç e veç të gjitha kompetencat në lidhje me administrimin e aktivitetit tregtarë të Shoqërisë të dhena nga ligji per administratorët e shoqërive, duke marrë kështu vendime apo duke kryer veprime ose mosveprime të vlefshme edhe nëse përbajnë nënëshkrimin e njërit prej administratoreve. Administratorët nëse e shikojnë të nevojshme kanë të drejtë të veprojnë edhe bashkarisht kundrejt të gjithë të tretëve persona fisik ose juridik privat apo shtetërorë të Republikës së Shqipërisë apo edhe jashtë sajë, bankave dhe cdo enti tjeter të parashikuar me ligji si brenda por edhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Administratorët do të janë bashkarisht përgjegjës nëse veprojnë të dy njëkohësisht përmes njësive të tjera përmes njësive të tjera, apo të marrin me shkrim aprosimativ ose njëri tjetrit.

Administratori kryen detyrat e ngarkuara nga ortaket e shoqërisë ne kete statut dhe te gjitha ato detyra te parashikuara dhe te përcaktuara nga ligji. Midis këtyre detyrave jane te përfshira ato qe renditen me poshtë:

- te veproje dhe te nënshkruaje ne emër te shoqërisë;
- te përpunoje rregulloren e brendshme te shoqërisë dhe një plan biznes për vitin financiar, mi cili do te aprovohet ne asamblenë e përgjithshme;
- te përpunoje çdo semestër raportet mbi aktivitetin e shoqërisë dhe tua prezantojnë ortakëve;
- te mbaje ne rregull regjistrin e vendimeve te asamblesë se përgjithshme;
- administratori janë përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe te tretëve për shkeljet e ligjit ose te normave te statutit qe ndodhin gjate ushtrimit të aktivitetit të vetë, ne baze te ligjit shqiptare;
- te kryej te gjitha aktivitetet e administrimit te aktivitetit tregtar te shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- te merret me mbajtjen e dokumenteve dhe te librave te llogarive te shoqërisë me korrektese dhe saktësi;

- te kryejnë regjistrimin dhe te dërgojnë te dhënat e nevojshme te shoqërisë, ashtu siç është parashikuar nga ligji per Qendrën Kombëtare te Biznesit;
- ti raportojne asamblesë se përgjithshme realizimin dhe kryerjen e politikave tregtare dhe per sa i përket realizimit te veprimeve specifike te një rëndësie te veçante ne aktivitetin e shoqërisë tregtare duke manaxhuar me korrekësi dhe vëmëndje shoqërinë;
- te kontrakoje marrëveshje me te tretet ne limitet e objektit te aktivitetit te shoqerise dhe te kompetencave te veta te përcaktuara nga asambleja e ortakeve duke aplikuar ne cdo raste rregulloren e brendeshme te shoqerise
- te përgjigjet për demet e sjella shoqërisë nga veprimet
- te paguhet për punën qe kryen ne baze te marrëveshjeve te bëra me ortaket themelues;
- te informohet dhe te beje propozime për çfarëdolloj gjeje qe e vlerëson te dobishme për shoqërinë;
- te kryej te gjitha aktivitetet bankare qe kane lidhje me llogarinë e shoqërisë;
- Cdo administratore i vetem ka te drejte dhe detyrim për mbledhjen e asamblesë se përgjithshme, ne baze dhe duke zbatuar dispozitat e këtij statuti dhe te ligjit;
- Te kryejne te gjitha detyrat e tjera te dhena nga ligji dhe Asambleja e Pergjitheshme e Shoqerise te cilat nuk jane pershkruar ne menyre specifike me siper.

#### **NENI 16**

#### **DETYRIMET DHE TË DREJTAT E SHOQËRISË:**

Shoqëria ka të drejtë:

- të kryejë veprimtari në bazë të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë;
- të siguroje pasurinë e saj;
- të marrë kredi në lekë dhe ne valute të huaj nga Bankat vendase ose të huaja në baze të normave ligjore në fuqi;
- të përfitoje nga favoret që i njeh legjislationi shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera.
- të investojë kudo në Shqipëri, dhe që mund të operojë edhe jashtë në bazë të legjisacionit shqiptar dhe të huaj me të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj;
- të punësojë punëtorë, vendas ose të huaj;
- të eksportoje lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj.

#### **NENI 17**

Shoqëria ka për detyre:

- të sigurojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohen e duhur;
- të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria;
- të sigurojë punonjësit e saj;
- të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktore ndaj cilitdo;
- të respektojë standardet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

#### **NENI 18**

#### **RAPORTET EKONOMIKE DHE FINANCIARE TË SHOQËRISË:**

Të gjitha aktivitetet e shoqërisë për plotësimin e objektit te saj, pasqyrohen ne bilancin ekonomik të saj.

#### **NENI 19**

Në selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, në bazë të cilit, brenda datës 31 Mars te çdo viti nxirret bilanci.

#### **NENI 20**

Viti finanziar fillon me 01 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

#### NENI 21

Shoqëria mban një ose më shumë llogari të shoqërisë në një ose më shumë banka. Llogaritë pasqyrohen në librat përkatës.

#### NENI 22

Nga fitimet e realizuara gjatë vittit finanziar, shoqëria, pasi bën zbritjen e humbjeve të vitit të mëparshëm, lë mënjane 5% te fitimit, me të cilin krijohet fondi "Rezervë i domosdoshëm", derisa ky fond të arrijë në masën 10% të kapitalit themeltar.

#### NENI 23

##### DISPOZITA TË VECANTA:

Shoqëria ka vulën e saj dalluese dhe mund te ketë një marke te saj.

#### NENI 24

##### TRASFORMIMI DHE SHPËRBËRJA E SHOQËRISË:

Shndërrimi i shoqërisë në shoqëri të tipave të tjera, mund të bëhet me vendim të ortakëve themelues sipas mënyrave të parashikuara nga ligji.

#### NENI 25

Shpërbërja e shoqërisë, mund të vije për shkaqet e parashikuara në nenin 99 te Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 dhe përsyjet si më poshtë:

- humbja e kapitalit të shoqërisë;
- pamundësi për veprim;
- me vendim të Ortakut të vetëm.

Në këto raste ortaket e shoqërisë vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose më shumë likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë deri sa ajo t'u dorëzohet personave përkatës fizikë e juridikë, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet që ka shoqëria ndaj personave të tretë.

Në rast se fondej e disponushme, rezultojnë te pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkoje ortakëve themelues të shoqërisë që të derdhin tërësisht kuotat qe i takojnë atyre.

#### NENI 26

Për sa nuk është parashikuar shprehimi i shoqërisë në ketë statut, do ti referohet legjislacionit shqiptar si edhe ndryshimeve të mëvonshme që do të kryen nga asambleja e përgjithshme e ortakeve sipas ligjit.

**ORTAKU I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**


**I&M PLATINUM TRADING LIMITED**

Për Ortakun

**I&M TRADING LIMITED D.O.O.**


Përfaqësues me prokurë

Fabjan Mehmeti



faqe | 6

Gentjan Zoto



02.27.2020